



Ndihmojuni fëmijëve tuaj të mësojnë

NDIHMOJUNI FËMIJËVE TUAJ TË MËSOJNË DERISA RRITE DHE TË RRITE DERISA MËSOJNË

Prindërit gjithnjë e kanë ditur se sa janë të rëndësishëm fëmijët e tyre. Njohuritë më të reja shkencore që kanë të bëjnë me zhvillimin e trurit vetëm na kanë ndihmuar ta kuptojmë se fëmijët fillojnë të mësojnë shumë më herët dhe shumë më tepër seç është menduar deri tash. Ato pohojnë se ndërlikohja e mirë ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, si dhe mbështetja që e marrin fëmijët nga prindërit, por edhe nga të gjithë të tjerët që kujdesen për ata – familja më e gjerë, mësueset në çerdhe, miqtë, farefisi – kanë ndikim të madh ndaj shëndetit të tyre, ndaj aftësisë së tyre për mësim të hershëm dhe ndaj zhvillimit të tyre të gjithmbarshëm.

Fëmijët vijnë në botë me shumë nevoja: nevojën për të qenë të dashur, nevojën për ushqim, nevojën për kujdes shëndetësor, nevojën për siguri sociale dhe emocionale. Por, ata po ashtu vijnë në botë edhe me potencial dhe nevojë të madhe që të mësojnë. Sa më herët që përmbushet nevoja e tyre për mësim të hershëm, aq më lehtë ata do të përgatiten për shkollë, por edhe për jetën në përgjithësi.

Ju, prindërit, por edhe të gjithë të tjerët që kujdesen për fëmijën, mund t'i ndihmoni fëmijës suaj që të ketë start sa më të mirë në jetë. Mënyra e sjelljes suaj deri në 5 vitet e para të jetës e përcakton se si do të rritet dhe zhvillohet fëmija juaj derisa është i vogël, por kjo sjellje e formëson edhe mënyrën në të cilën fëmija juaj do të mësojë, do të mendojë dhe do të sillet në të ardhmen. Ndonëse roli prindëror zhvillohet spontanisht nëpër aktivitetet e përditshme, megjithatë prindërit kanë nevojë për mbështetje në realizimin e suksesshëm të rolit të tyre prindëror.

Secili prind së paku një herë në jetë e ka pyetur veten se sa është prind i suksesshëm.

Kjo broshurë do t'ju tregojë se me ndihmë të vogël prindëria është e thjeshtë, e lehtë, argëtuese dhe e leverdishme. Koha, dashuria dhe kujdesi juaj janë dhurata më e mirë dhe investimi më afatgjatë që mund t'ia jepni ju fëmijës suaj.

Mos shpenzoni para për lodra të mira – lodra më e mirë për fëmijën tuaj jeni pikërisht ju.

BAZA PËR JETË TË SUKSESSHME DHE TË LUMTUR KRIJOHET GJATË 5 VITEVE TË PARA TË JETËS!

Zhvillimi dhe gatishmëria e fëmijëve tuaj për shkollë varen nga shumë gjëra: gjendja shëndetësore, pjekuria socio-emocionale, aftësitë gjuhësore dhe dituritë e përgjithshme për botën që i rrethon ata.

Shëndeti dhe mirëqenia fizike

Fëmijët e vegjël kanë nevojë për ushqim të shëndetshëm. Fëmijët e moshës 2 deri në 5-vjeçare mund ta hanë ushqimin e njëjtë si të rriturit, por vetëm në sasi më të vogla. Ata duhet të hanë ushqim të llojllojshëm, duke përfshirë edhe: bukë integrale, drithëra, pemë e perime, mish, peshk, vezë, qumësht, jogurt. Ushqimi që ka shumë yndyra dhe sheqer nuk është i shëndetshëm as për fëmijët.

Fëmija i vogël ka nevojë për aktivitet fizik. Që të mësohet t'i kontrollojë dhe koordinojë muskujt e duarve dhe të këmbëve, ai duhet të mund ta hedhë dhe ta kapë topin, të vrapojë, të kërcejë, të ngjitet nëpër shkallë dhe të vallëzojë sipas ritmit të muzikës.

Që të mësohet t'i kontrollojë dhe koordinojë muskujt e vegjël të duarve dhe gishtave, ai duhet të ngjyrosë me ngjyra, të bashkojë loja për harmonizimin, katrorë, të hedhë sende të vogla, siç janë paratë, të presë me gërshërë të sigurt, të palosë dhe shpalosë pallto etj.

Fëmijët kanë nevojë për vizita të rregullta te mjeku, për vaksinim dhe kujdes të dhëmbëve. Imunizimi me kohë do t'i ndihmojë fëmijës që mos të sëmuret nga shumë sëmundje, siç janë: fruthi, shytat, difteria, kolla e madhe, paraliza e fëmijëve, verdhëza etj. Të gjitha këto sëmundje mund të kenë pasoja serioze për shëndetin dhe zhvillimin e përgjithshëm të fëmijës. Duke filluar që nga mosha trevjeçare, fëmija kuaj ka nevojë edhe për vizita të rregullta te stomatologu.

Përgatitja socio-emocionale

Deri në vajtjen e tyre në shkollë fëmijët arrijnë shkallë të ndryshme të pjekurisë sociale dhe emocionale. Ajo është, në fakt, mënyra se si ata i kontrollojnë ndjenjat e tyre dhe si gjenden ata në marrëdhënie me njerëzit e tjerë. Zhvillimi socio-emocional është veçmas i rëndësishëm, sepse ka të bëjë me të gjitha pjesët e jetës së fëmijës, duke përfshirë edhe sjelljen e tij në shtëpi, aftësinë për të krijuar miq, dëshirën për të provuar gjëra të reja, aftësinë për t'u ballafaquar me probleme dhe suksesin e ardhshëm në shkollë. Duke i ndihmuar fëmijës suaj që të arrijë pjekuri (shkathësi) socio-emocionale, fëmija juaj do të jetë:

- I lumtur dhe plot vetëbesim
- I aftë që të gjejë dhe të mbajë miq
- I suksesshëm në shkollë
- I aftë që të zgjedhë drejtim të mirë dhe të ndjekë rregulla të mira
- I aftë që të ballafaqohet me situata të stresit
- I aftë që t'i shprehë nevojat e tij.

Në arritjen e këtyre aftësive, fëmijës suaj i duhet kohë, por edhe mbështetje nga të rriturit. Rritni gjasat e fëmijës suaj që ai të arrijë shkathësi socio-emocionale, siç janë:

- Vetëbesimi: fëmijët patjetër duhet të ndjehen të kënaqur me veten e tyre dhe të besojnë se mund të jenë të suksesshëm. Inkurajoni që të provojnë gjëra të reja dhe të përpiqen më shumë derisa t'ia dalin;
- Pavarësia: fëmijët patjetër duhet të mësojnë t'i bëjnë gjërat vetë;
- Motivimi: te fëmijët mund dhe duhet të zhvillohet dëshira për mësim;
- Kureshtja: mos e ndrydhni kureshtjen e tyre – ajo është njëra ndër tiparet kryesore për mësim;
- Qëndrueshmëria: inkurajoni që ta përfundojnë atë që e kanë filluar;

- Kooperimi (ose bashkëpunimi): nxiteni lojën e përbashkët me fëmijët e tjerë, që ashtu të mësohen të bashkëpunojnë dhe t'i ndajnë gjërat me të tjerët;
- Vetëkontrolli: fëmijët duhet të mësojnë se ka mënyra të mira dhe të këqija për ta shprehur tërbimin dhe se disa nga ato mënyra, siç është goditja dhe rrahja, janë të papranueshme;
- Empatia: fëmijët mundet dhe duhet ta kuptojnë se si ndjehen njerëzit e tjerë;

Disa këshilla si t'u ndihmoni fëmijëve që t'i zhvillojnë këto shkathtësi:

- Dëshmoni fëmijës se e doni dhe se kujdeseni për të. Fëmijët që ndjehen se janë të dashur, kanë më shumë vetëbesim. Kushtoni fëmijës suaj më shumë kohë e mbështetje, përqafojeni dhe mbajeni në prehër sa më gjatë;
- Jepni shembull të mirë. Fëmijët e imitojnë atë që e shohin dhe dëgjojnë nga të tjerët. Kur ju të silleni ndaj të tjerëve me respekt, edhe ai do të silllet ashtu. Nëse ju i ndihmoni të tjerët, ashtu do të mësohen edhe fëmijët që të kenë mirëkuptim për ndjenjat e të tjerëve;
- Krijojuni mundësi që t'i përsërisin gjërat. Nevojitet kohë dhe ushtrime që fëmija të mësohet të zvarritet, të shqiptojë disa fjalë ose të mësojë të pijë nga gota. Mos u brengosni se mos ndoshta përsëritja për të është diçka e mërzitshme. Përkundrazi, përmes përsëritjes ata jo vetëm që mësojnë, por edhe e krijojnë vetëbesimin e nevojshëm që të provojnë gjëra të reja dhe të vazhdojnë më tutje;
- Shfrytëzoni masa përkatëse të disiplinës. Të gjithë fëmijët kanë nevojë që t'u vendosen kufij. Ja disa ide se si t'i vendosni ato kufij:
 - orientojeni fëmijën çka të bëjë, por mos e urdhëroni
 - shpjegojani fëmijës shkakun pse kërkoni nga ai që të bëjë diçka
 - („Hiqe topin nga shkallët, sepse dikush mund të pengohet!” në vend të: “Hiqe topin, sepse ashtu të them unë!”)
 - dëgjojeni fëmijën tuaj kur ju flet, që ta zbuloni se si ndjehet dhe a ka nevojë për më shumë mbështetje
 - kritikojeni sjelljen e tij, por jo atë personalisht (“Ti je djalë i mirë, por nuk bërë mirë që e shtyve motrën tënde. Kjo mund ta lëndojë atë.”)
 - zgjidhni problemet bashkërisht (“Çka të bëjmë që vëllai yt mos të t'i rrëzojë katrorët?”)
 - bëhuni pozitivë dhe inkurajojeni. Buzëqeshni dhe lavdërojeni sjelljen e tij të mirë, në vend që të fokusoheni vetëm në atë që është negative
 - nxiteni të bëjë sa më shumë gjëra vetë (të vishet, t'i mbledhë lodrat)
 - mundësoni të ketë zgjedhje – mos zgjidhni dhe mos vendosni ju në vend të atij.
- Inkurajojeni të luajë me fëmijët e tjerë dhe të rrijë me të rritur që nuk janë pjesë e familjes. Fëmijët që kanë mundësi të njoftojnë më shumë fëmijë dhe të rritur, si dhe të dëgjojnë mendime të ndryshme, pajtohen më mirë me mësueset dhe me nxënësit e tjerë në shkollë.
 - Shfaqni qëndrim pozitiv ndaj mësimit dhe ndaj shkollës dhe shprehni mahnitjen tuaj kur ai të bëjë diçka (“Sa vizatim të bukur ke bërë, sa shumë ngjyra ka në të!”), që ai të ndjehet krenarë më veten e tij dhe të arriturat e tij.

Gjuha dhe dituritë e përgjithshme

Ku mësojnë fëmijët?

Vendi më i mirë për mësim është shtëpia, ndërsa mësuesit e parë dhe njëherazi më të rëndësishëm janë prindërit. Fëmijët mësojnë përmes asaj se si sillen të tjerët me ata, si dhe nga ajo që e shohin, që e dëgjojnë dhe nga ajo që e përjetojnë, duke filluar që nga dita e parë e lindjes. Fëmijët janë “të lindur për të mësuar”. Në periudhën e pesë viteve të para, veçmas gjatë kohës së tre viteve të para, ata mësojnë shumë më shpejt dhe shumë mirë. Pikërisht për këtë prindërit, por edhe të gjithë ata që kujdesen për fëmijën, e kanë në vetvete fuqinë që të ndikojnë ndaj aftësisë së fëmijës që të mësojë, madje edhe shumë më herët se të shkojë në shkollë.

Si mësojnë?

Fëmijët mësojnë në mënyra të ndryshme: derisa shikojnë e dëgjojnë, e veçmas derisa “bëjnë” diçka. Gjatë kësaj ata kalojnë nëpër shumë faza, por secila nga ato nuk zgjat njësoj për secilin fëmijë. Fëmija shumë shpejt do të përparojë nëse rritet në mjedis ku ndjehet i dashur dhe i sigurt, por edhe ku do ta ketë më interesant. Ju do t’i ndihmoni në këtë mënyrë:

- *Mundësojuni që të luajë* – për fëmijët loja është mënyrë e mësimit. Ajo është mënyrë natyrore e hulumtimit: të jenë kreativë, të shpikin, ta zhvillojnë imagjinatën dhe t’i zhvillojnë shkathtësitë sociale. Loja u ndihmon edhe të mësojnë të zgjedhin probleme – për shembull, nëse del treni nga binarët, ai duhet të gjejë mendim si ta kthejë prapë. Derisa radhit katrorë, i mëson ngjyrat dhe format, si dhe mëson të numërojë. Loja me fëmijë të tjerë u ndihmon atyre të mësojnë edhe shkathtësi të zhvillimit të bisedimeve;
- *Ndihmojeni dhe mbështeteni në lojë*. Për shembull, derisa i harmonizon pjesët e lodrës për harmonizim, tregoni dhe ndihmoni në fillim derisa të bëhet i vetëdijshëm dhe i aftë që vetë t’i gjejë pjesët. Kur të shihni se përparon, lëreni vetë – atëherë gjithnjë e më pak do të ketë nevojë për ndihmën tuaj;
- *Flisni fëmijës që nga dita e parë*. Fëmija juaj ka nevojë që ta dëgjojë zërin tuaj. Tingujt e TV-së ose të radios nuk mund ta zëvendësojnë zërin tuaj, sepse ato nuk u përgjigjen drejtpërdrejt tingujve dhe nevojave tuaja. Foshnja juaj patjetër duhet ta dijë se kur i ikin tinguj të caktuar, nëna ose babai i tij, si dhe ndonjë i rritur nga mjedisi i tij, do t’ia kthejë me zë të këndshëm dhe me buzëqeshje. Sa më shumë që i flisni foshnjës suaj, aq më shumë dhe më shpejt ai do të mësojë, do të flasë më mirë dhe do të shprehet më lehtë kur të rritet. Aktivitetet e përditshme ju japin mundësi të shumta për të folur, derisa e vishni, e lani dhe e ushqeni. Derisa e lani, mund t’i thoni: “Hajde së pari ta mbushim koritën. A do që edhe merimanga e gomës të lahet me ty? Shih, merimanga është e verdhë, njësoj si edhe peshqiri yt”;
- *Dëgjojeni fëmijën tuaj*. Fëmijët i kanë mendimet, ndjenjat, shpresat dhe frikat e tyre. Ash-tu siç mësohet të flasë, inkurajojeni që ta flasë atë që e mendon dhe ndjen. Dëgjimi është mënyra më e mirë që ta kuptoni atë që e ka në mendje, që e di dhe nuk e di, si mendon dhe si mëson. Njëherazi, kështu i dëshmoni edhe se ju i respektoni mendimet dhe ndjenjat e tij;
- *Parashtroni pyetje*, veçmas pyetje të tilla që nuk kërkojnë përgjigje të thjeshtë (po ose jo). Për shembull, kur shëtiteni jashtë shtëpisë, potenconi se gjethet e rëna nga druri kanë ngjyra të ndryshme. Pyeteni: “Çfarë rritet në dru, përveç gjethit?”;
- *Përgjigjuni në pyetjet e tij dhe*, sa herë që është e mundur, inkurajojeni që vetë ta gjejë përgjigjen. Nëse nuk e dini përgjigjen, thoni se as ju nuk e dini dhe përpiquni që bashkërisht ta gjeni;

- *Lexoni me zë fëmijës suaj çdo ditë.* Fëmijët e të gjitha moshave dëshirojnë t’u lexohet me zë, madhe edhe foshnjat që sapo i kanë mbushur 6 muaj. Ndonëse foshnja është e vogël që ta kuptojë përmbajtjen e asaj që e lexoni, kjo i ndihmon asaj që ta mësojë gjuhës dhe të kënaqet me zërin dhe me praninë tuaj. Nuk është patjetër që ju të jeni të shkëlqyeshëm në lexim – ngrohtësia e pranisë suaj dhe e afërsisë suaj te ai krijon dashuri ndaj leximit dhe shprehi leximi kur të rritet.

Nuk është patjetër të jeni të shkëlqyeshëm në lexim që fëmija të kënaqet në momentet kur i lexoni.

- Kontrollojeni se çka shikon në TV. Programet cilësore të TV-së mund të jenë të dobishme dhe t’i mundësojnë fëmijës mundësi të reja për mësim dhe për zbulimin e botës, por programet e këqija dhe shumë të gjata në TV mund të jenë të dëmshme dhe të krijojnë varësi. Ju jeni ata që duhet të vendosni se kur dhe sa do të shikojë fëmijë TV fëmija juaj. Asnjëherë mos e lini fëmijën të shikojë TV vetë. Shikoni bashkë TV dhe bisedon për atë që e shikoni.
- Bëhuni realë rreth aftësive dhe interesave të fëmijës suaj. Vendosni të pritura të larta dhe inkurajojeni të kërkojë gjëra të reja.

Fëmijët prej të cilëve nuk kërkohet asgjë mërziten. Por, fëmijët nga të cilët kërkohet shumë ose nga të cilët kërkohet të bëjnë diçka që nuk u intereson, bëhen të dëshpëruar dhe të frustruar.

- Krijoni mundësi që fëmija të shohë dhe të bëjë gjëra të reja. Sa më shumë vende të ndryshme që të vizitojë dhe shohë fëmija, aq më shumë do të mësojë për botën. Pa marrë parasysh se ku jetoni, dilni në shëtitje në mjedisin më të afërt ose pak më larg me autobus. Vizitoheni kopshtin zoologjik, muzeun, bibliotekën, parkun ose ndonjë vend tjetër interesant. Nëse jetoni në qytet, kaloni një ditë në fshat; nëse jetoni në fshat, kaloni një ditë në qytet. Jepni fëmijës mundësi të luajë, të këndojë, të ngjyrosë dhe të bëjë gjithçka që mund ta nxisë kreativitetin e tij dhe t’i mundësojë t’i shprehë ndjenjat e tij.

10 këshilla për prindërit, që mund të ndihmojnë në marrëdhënien e tyre ndaj fëmijëve të të gjitha moshave

- **Nuk është lehtë të jesh prind – prandaj është mirë ndonjëherë ta pyetni veten a jeni prind të mirë;**
- **Është krejt në rregull që të ndonjëherë të kërkonit ndihmë;**
- **Vendosni rregulla të qarta dhe përpikuni të mos i shkelni shpesh ato;**
- **Dëgjojeni fëmijën tuaj – lejoni t’i shprehë ndjenjat dhe mendimet e tij;**
- **Lavdërojeni sjelljen e mirë në vend që ta shpërbleni me dhurata;**
- **Modelojeni sjelljen e fëmijës ashtu siç prisni nga ai të silltet (thoni: “Faleminderit”, “Të lutem”, “Më vjen keq”, “Ta fal”);**
- **Të jeni i bindur se të gjithë të rriturit e mjedisit të tij “punojnë bashkërisht”;**
- **Bëhuni të qëndrueshëm dhe racionalë, por njëherazi shfaqni edhe respekt dhe durim ndaj fëmijës;**
- **Kur fëmija të bëjë diçka të pahijshme, të keqe, mbani mend se nuk është fëmija i keq, porse e keqe është sjellja e tij – ai ende është duke mësuar si të silltet;**
- **Kufizojani shikimin e TV-së. Në vend të kësaj inkurajojeni të luajë me fëmijët e tjerë ose merrni pjesë edhe ju në lojë me të;**

- Përmbahuni sa shumë që mundeni ndaj rutinës ditore në raport me ushqimet dhe fjetjen;
- Ju dhe fëmija juaj mund të keni karakter dhe temperament të ndryshëm – përpquni të gjeni gjuhë të përbashkët;
- Njoftoni njerëzit me të cilët fëmijët e kalon kohën e tij (edukatorët në çerdhe, përkëdhelëset, prindërit e shokëve të tij) – ata janë partnerët tuaj në edukimin e fëmijës suaj;
- Mësojeni ta mundë tërbimin e vet;
- Të gjithë fëmijët kanë dobi nga ndërveprimi pozitiv me të rriturit.

10 regullat themelore që mund t'ju lehtësojnë rolin tuaj të prindit

1. Doni fëmijët tuaj, shfaqni dashuri dhe ngrohtësi ndaj tyre

Kur fëmijët e vegjël janë të rrethuar me dashuri e ngrohtësi në shtëpi, ata ndjehen të sigurt. Ndjenja e sigurisë gjatë afërsisë me një person të njohur e të dashur, shpie në rritje të shpejtuar dhe zhvillim pozitiv të fëmijës së vogël dhe ndikon ndaj mënyrës në të cilën punon dhe zhvillohet truri i tij.

2. Përgjigjuni drejt ndaj mesazheve që jua dërgon fëmija

Foshnjat dhe fëmijët e vegjël, edhe pse nuk dinë të flasin, i shprehin nevojat e tyre dhe disponimin e tyre momental në mënyrën e tyre: përmes lëshimit të tingujve dhe zërave të ndryshëm, përmes lëvizjes së trupit, përmes kontaktit me sy ose përmes shprehjes së fytyrës. Ata ndjehen të sigurt kur në afërsi të tyre është një person i rritur i cili përpqet "t'i lexojë" këto mesazhe dhe të përgjigjet drejt në ato. Ata fillojnë të besojnë se nëse buzëqeshin, dikush do t'ua ktheje me buzëqeshje të ngrohtë; nëse janë të shqetësuar, dikush do të përpqet t'i qetësojë; nëse janë të uritur, dikush do t'i ushqejë.

Prindërit shpeshherë pyeten: "A do të lazdrohet fëmija im nëse i kushtoj aq shumë vëmendje?"

Jo. Prindërit nuk mund ta bëjnë të lazruar fëmijën e tyre duke u përgjigjur drejt ndaj nevojave të tij. Sot dihet me siguri se foshnjat, prindërit e të cilëve reagojnë shpejt ndaj shqetësimit dhe vajit të fëmijës me ngrohtësi dhe përqafim, qajnë më pak dhe flenë më shpejt.

3. Flisni, lexoni dhe këndonni fëmijës

Prindërit shpesh pyeten se pse foshnja i vogël ka nevojë t'i lexohet, t'i flitet dhe t'i këndohet edhe para se të fillojë të flasë. Kur foshnjat të dëgjojnë vazhdimisht fjalë të caktuar, pjesët e trurit që janë përgjegjëse për të folurit zhvillohen më shpejt. Kjo është edhe një mundësi e mirë për të vendosur marrëdhënie të afërsisë prind-fëmijë.

Ju mund t'i lexoni ilustrim edhe një foshnjeje dhe fëmije shumë të vogël. Qysh në moshën 6-muajshe ai shfaq shenja të kënaqësisë nga lëvizja e këmbëve dhe duarve kur shikon në fotografitë e librit. Mënyra se si i lexohet libër fëmijës së vogël është shumë e rëndësishme – inkurajojeni fëmijën që të marrë pjesë aktive në procesin e leximit:

- Të parashtrijë pyetje dhe të përgjigjet;
- Të tregojë se çka shikon në fotografi;
- Të parashtrijë se çka mund të ndodhë në përrallë në faqen vijuese

Shpjegojani përrallën dhe lexojani përrallën e njëjtë disa herë. Leximi dhe shpjegimi i përrallave të njëjta mund të duket e mërzitshme për prindërit, por jo edhe për fëmijët. Ata mësojnë duke përsëritur.

4. Përcaktojeni ritmin e aktiviteteve të përditshme të sigurta dhe lehtë të parashikueshme

Foshnjat dhe fëmijët e vegjël i dallojnë lehtë aktivitetet e zakonshme të përditshmërisë që përsëriten. Një foshnje e di se kur është koha për gjumë nëse nëna fillon t'ia këndoje këndën e dëshiruar. Një fëmijë tjetër e di se kur është koha që babai i tij ta marrë nga çerdhja, sepse ia kanë shtruar ushqimin. Përsëritja e përvojave të mira krijon lidhje të fuqishme në trurin e fëmijës dhe e krijon ndjenjën e sigurisë. Përvoja e përsëritur pozitive e mëson fëmijën se çka mund të presë nga mjedisi që e rrethon. Fëmijët që rriten në mjedis të sigurt dhe lehtë të parashikueshëm shfaqin edhe më shumë gatishmëri për të mësuar dhe për më shumë sukses në shkollë.

5. Nxiteni foshnjën të hulumtojë dhe të luajë

Gjatë disa muajve të parë prindërit janë gjithë bota e fëmijës. Duke u rritur, ata fillojnë të zvarriten dhe të ecin. Në atë periudhë ata fillojnë ta studiojnë botën përreth dhe të dalin jashtë botës së prindërve. Prandaj prindërit duhet ta inkurajojnë këtë nevojë të fëmijës, por njëherazi edhe ta pranojnë kur ai shfaq dëshirë të kthehet në botën e tyre për shkak të nevojës për siguri.

Loja është e rëndësishme njësoj si përvoja për mësim. Derisa shumica prej nesh mendojnë se mësimi është vetëm përvetësim i diturive dhe fakteve, fëmijët, në fakt, mësojnë pikërisht përmes lojës. Vëzhgoni fëmijët derisa luajnë dhe menjëherë do të shihni se sa shumë mësojnë derisa luajnë.

6. Bëni përzgjedhje të asaj që fëmija do ta shikojë në televizion

Derisa shikoni TV, bëhuni përzgjedhës i asaj që fëmija do ta shikojë dhe mos lejoni që televizori t'i edukojë fëmijët në vendin tuaj.

Televizioni vetvetiu nuk mund ta mësojë fëmijën të flasë dhe të komunikojë. Sot ekzistojnë dëshmi të shumta se fëmijët që shfaqin sukses më të madh në shkollë, kanë pasur edhe prindër që e kanë kufizuar shikimin e televizionit dhe kanë qenë përzgjedhës të mirë të qasjes në atë se çka dhe sa kanë shikuar fëmijët e tyre TV. Disa emisione televizive mund të jenë argëtuese për fëmijët, por një pjesë e madhe e tyre krijojnë huti te ata ose janë të tmerrshme.

Prandaj sa herë që keni mundësi, uluni dhe shikojeni programin televiziv bashkë me fëmijët dhe bisedoni me ata për atë që e shihni.

7. Shfrytëzoni disiplinën si mundësi për mësim

Duke u rritur, fëmijët gjithnjë e më shumë dëshirojnë të gjurmojnë dhe të eksperimentojnë. Në këtë proces fëmijët kanë nevojë për mbikëqyrje të vazhdueshme nga ndonjë person i rritur që është i dashur dhe i afërt me ata. Mbikëqyrja e të rriturve duhet të shfrytëzohet si formë e mësimi, e jo si formë e ndalimeve dhe kufizimeve

Mos prisni nga fëmijët e vegjël që çdoherë ta bëjnë atë që ua thoni ju. Normalisht, edhe ata dëshirojnë të jenë impulsivë, të godasin, të bërtasin, të qajnë, sepse ata ende nuk e kanë aftësinë e kontrollimit të hidhërimit të tyre. Po ashtu është krejt normale për fëmijët e vegjël që "t'i testojnë" rregullat duke i thyer ato. Kur i mbështetni njësoj në këto përpjekje, ju u ndihmoni që ata të ndjehen të sigurt, e jo të kufizuar. Ekzistojnë mënyra të shumë si t'u ndihmoni fëmijëve që rregullat t'i vendosin duke mësuar, e jo me dënim.

- Bisedoni me fëmijën se çka duhet të bëhet në momentin e dhënë kur ai të hidhërohet: "E di se është mirë të luash në park, por tash është koha të shkojmë në shtëpi"
- Orientojeni vëmendjen e fëmijës në ndonjë aktivitet tjetër duke përdorë gjuhë pozitive dhe neutrale: "Nuk është mirë të vizatohet me fllomasterë në mur – ja disa fletë të letrës në të cilat mund të vizatosh"

- Thoni fëmijës “JO” dhe tregoni se sa e doni: “Unë të dua shumë ty, por jo edhe atë që e bën”.
- Jepni fëmijës gjithnjë shpjegim se pse i vendosni rregulla: “Mos vrapo me gërshërë në duar, sepse mund të rrëzohesh dhe të lëndohesh”.
- Jepni fëmijës suaj ndonjë detyrë konkrete: “Të lutem, ngrije nga dyshemeja ariun e kadifenjtë” (në vend që t’i thoni: “Pastroje dhomën”).
- Njihni dhe emërtoni ndjenjat e fëmijës: “E di se je i hidhëruar, por mos e godit shokun tënd”.
- Ndhmoni fëmijës që ta kuptojë se si ndikon aktiviteti i tij ndaj të tjerëve: “Motra jote është e shqetësuar, sepse ti e ke pickuar. Si do të ndjeheshe ti nëse dikush të lëndon?”
- Ndhmoni fëmijës që të përdorë fjalë për t’i shprehur ndjenjat e tij: “Thuaj vëllait tënd se ty nuk të vjen mirë kur dikush të godet”.
- Lavdërojeni sjelljen e mirë të fëmijës: “Ti vërtet bëre mirë që e ngrite ariun tënd të kadifenjtë. Të faleminderit”.

Asnjëherë mos e goditni e as mos e shkundni fëmijën tuaj. Kjo formë e “disiplinës mund të ketë pasoja të padëshirueshme afatgjata për zhvillimin e fëmijës dhe e vetmja gjë që mund të ndjejë fëmija në atë rast është frika, ofendimi, mllëfi dhe ashtu vetë të bëhet edhe vetë i dhunshëm. Prandaj është mirë “të numëroni deri në 10” dhe çdoherë ta komentoni sjelljen e keqe të fëmijës, e jo vetë fëmijën. Mos bërtisni: “Ti je fëmijë i ligë”, por: “Bërtitja dhe goditja e vëllait më të vogël nuk është gjë e mirë”.

Nëse ndonjëherë dyshoni se a keni reaguar ndaj fëmijës siç nuk keni dëshiruar, thoni fëmijës se keni gabuar dhe kërkon falje.

8. Pranoni që secili fëmijë është i veçantë

Fëmijët e ndryshëm kanë temperamente të ndryshme. Një fëmijë mund të jetë shumë i hapur dhe i shoqërueshëm, ndërsa vëllai ose motra e tij mund të jetë i/e turpshëm/turpshme. Fëmijët zhvillohen në mënyra të ndryshme. Sesi e përjetojnë fëmijët veten e tyre, kjo varet nga qasja që e kanë të rriturit ndaj fëmijëve dhe si sillen ata me fëmijët. Kur fëmijët arrijnë të ballafaqohen me sfidat e përditshme, veçmas kur për këtë edhe lavdërohen, ata ndjehen të sigurt në veten e tyre. Kur fëmijët lavdërohen si të veçantë (“Bravo, u ngjite shkallëve vetë”), ata e zbulojnë lidhjen ndërmjet aktivitetit të tyre dhe përgjigjes suaj. Fëmijët që kanë vetëbesim dhe vetërespekt më të madh, rëndom janë të rrethuar me të rritur që i njohin nevojat e tyre dhe që u përgjigjen drejt atyre.

9. Zgjidhni kujdes cilësor për fëmijën tuaj dhe inkuadrohuni edhe ju në atë

Hulumtimet e fundit kanë dëshmuar se fëmijët që ndjekin çerdhe cilësore janë të përgatitur më mirë për shkollë dhe tregojnë sukses më të mirë aty. Ata kanë aftësi më të mira gjuhësore, shprehen më lehtë, mësojnë më shpejt të lexojnë dhe e përvetësojnë më lehtë programin mësimor. Zgjedhja e çerdes së mirë në të cilën fëmija juaj do të jetë i përkëdhelur, ku do të mësojë dhe ku do të nxitet zhvillimi i tij, është njëri nga vendimet kryesore që e merr familja për përparimin e zhvillimit të fëmijës. Një numër i madh i studimeve dëshmojnë se fëmijët që kanë pasur edukim dhe arsim të mirë parashkollor shumë cilësor, shfaqin shkathtësi dhe kapacitete më të mëdha sociale për mësim kur shkojnë në shkollë. Në veçanti është e rëndësishme që edhe prindërit të bashkëpunojnë me çerdhet. Njëherazi personeli i çerdheve duhet ta dijë se secili fëmijë shkon në çerdhe me shkallë të ndryshme të zhvillimit socio-emocional dhe duhet të sigurojë mbështetje përkatëse për secilin fëmijë.

Që të merrni vendim të drejtë, vizitoheni çerdhen dhe shihni se si sillen edukatorët me fëmijët derisa kujdesen për ata. Zgjidhni një edukator që ka vullnet ta nxisë mësimin te fëmijët e vegjël, i cili është i gatshëm t'i kushtojë vëmendje secilit fëmijë veçmas dhe i cili di t'i inkuadrojë fëmijët në lojë në mënyrë argëtuese dhe kreative. Gjeni një çerdhe që është e pastër dhe e sigurt, ku fëmijët do të ketë mjaft edukatorë që kanë mundësi t'i kushtojnë kujdes secilit fëmijë.

Secili fëmijë dhe secili prind janë të shqetësuar kur fëmija duhet të shkojë çerdhe – kjo për të është një hap i madh. Flisni atij për gjëra të bukura, të cilat do t'i mësojë në çerdhe, siç janë këngët, vizatimi, loja me lodra interesante, me shkronja e me numra. Flisni me mahnitje për të gjitha ato gjëra të rëndësishme që ai do t'i mësojë nga mësueset.

Pasi të merrni vendim, inkuadrohuni në mënyrë aktive në procesin e kujdesit dhe edukimit të fëmijës. Vizitoheni çerdhen përkohësisht dhe shihni se si duket bota e fëmijës suaj derisa nuk jeni me atë. Bisedoni me edukatorin se çka dhe si mëson fëmija juaj gjatë qëndrimit në çerdhe. Ofroni çdoherë udhëzime konstruktive se si të përmirësohet përvoja e fëmijës dhe procesi i mësimin të hershëm në çerdhe.

10. Kini kujdes veten tuaj

Megjithatë, edhe prindërit dhe ata që kujdesen për fëmijët e vegjël, po ashtu kanë nevojë për ndihmë. Kujdesi i prindërve është detyra më e përgjegjshme, e cila bart sfida të mëdha. Meqë familja dhe prindërit janë mjedisi i parë në të cilin foshnjat dhe fëmijët e vegjël fillojnë të mësojnë për botën, shëndeti dhe mirëqenia e prindërve janë po ashtu shumë të rëndësishme. Kur prindërit janë të brengosur, të shqetësuar ose të zënë me detyrime të tjera, e kanë më vështirë të gjejnë kohë që t'u përkushtohen fëmijëve të vegjël dhe nevojave të tyre. Në kushte të tilla shpesh bëhen gabime, por gjithnjë ekzistojnë mundësi edhe për përmirësim. Dhe, mbani mend, ekzistojnë shumë mënyra se si ta arrini atë. Familja më e gjerë, fqinjët, mjekët, punëtorët socialë dhe profesionistët e tjerë të fushës së zhvillimit hershëm të fëmijës mund t'ju ndihmojnë në këtë.